

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E
LISTËS SË ZGJEDHËSVE, TE NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 12 pika 4, nenit 20 pika 1 shkronja “dh”, nenit 24 pika 5, nenit 25 pikat 1 dhe 12, nenit 46 pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e dy anëtarëve, Komisioni Rregullator,

V E N D O S I:

1. Në Kreun **III.2. Regjistrimi në listën e zgjedhësve**, shkronja “a” e pikës 3, riformulohet si vijon:
..*“Skanon përmes PER një dokument identifikimi biometrik, pasaportë për jashtë shtetit ose letërnjoftim, të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, ose dokument identifikimi biometrik, pasaportë për jashtë shtetit ose letërnjoftim, të lëshuar nga vendet e Bashkimit European, vendet e Zonës Schengen, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Australi, Zelandë e Re dhe çdo vend tjetër pjesë e Marrëveshjes së Zonës ekonomike EEA. PER lexon dhe ngarkon automatikisht në platformë të dhënat që përmban dokumenti i identifikimit. Nëse për arsye të ndryshme këto të dhëna nuk ngarkohen automatikisht, atëherë zgjedhësi i ngarkon ato në PER në mënyrë manuale. Në çdo rast PER i krijon mundësi zgjedhësit që të ngarkojë të skanuar dokumentin përkatës të identifikimit. ...”*.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E
LISTËS SË ZGJEDHËSVE”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË
FUQI

Në mbështetje të nenit 12 pika 4, nenit 20 pika 1, shkronja “dh”, nenit 24 pika 5, nenit 25 pikat 1 dhe 12, nenit 46 pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një anëtarë të Komisionit Rregullator, Komisioni Rregullator vihet në lëvizje si organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij.

Neni 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Po në nenin 12 pika 4 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: “Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmblihen me kërkesë të çdo anëtarë”.

Neni 20, pika 1, shkronja “dh” e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Në nenin 24, pika 5 të Kodit zgjedhor përcaktohet se: “Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të Rregullatorit, me propozimin e Komisionerit, brenda 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Neni 25, pika 1 dhe 12, parashikon se: Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe parashikon gjithashtu kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e akteve të nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së



zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe afatet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.

Neni 46, pika 3 e Kodit Zgjedhor, parashikojnë se: *Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor.*

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioni Rregullator, me qëllim normimin e rregullave të regjistrimit të votuesve nga jashtë, miratoi më datë 23.10.2024 Vendimin nr 10/2024 “PER MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”.

Qëllimi i këtij akti ishte regjistrimi gjithëpërfshirës e me akses të barabartë të zgjedhësve në listën e zgjedhësve jashtë vendit, bazuar në vullnetin e tyre të lirë për të ushtruar një të drejtë themelore kushtetuese të garantuar e të patjetërsueshme, pa dallim për të gjithë zgjedhësit tashmë, duke i dhënë mundësinë që praktikisht shtesatit shqiptarë ta ushtrojnë të drejtën e votës edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje me parimet e procedurat e detajuara në vendimin nr.10/2024 të KRR, rezulton se çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet për Kuvendin nga atje ku ndodhet, duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit.

Konkretisht, parimet themelore e thelbësore mbi të cilat duhej të ngrihej procesi i regjistrimit të shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit janë si vijon:

- (i) Parimi i transparencës;
- (ii) Parimi i thjeshtësisë dhe lehtësisë;
- (iii) Parimi i efektshmërisë;
- (iv) Parimi i gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë ; dhe
- (v) Parimi i diskrecionit.

Siç jeni në dijeni, nga data e miratimit të këtij akti e deri më sot më datë 24.02.2025 ora 13:30, figurojnë rreth 220.000 kërkesa unike për regjistrim të zgjedhësve shqiptarë me banim jashtë vendit, nga ku rezulton se janë regjistruar rreth 175.000 zgjedhës unikë, si dhe janë refuzuar mbi 39.000 zgjedhës unikë.

Numri i lartë i refuzimeve në PER, padiskutim që është prova e drejtëpërdrejtë që tregon se parimet e gjithëpërfshirjes dhe lehtësisë janë dy parimet e cënuara e të pa zbatuara në thelb. Nga ana tjetër ky fakt provon dhe është tregues i qartë i keq organizimit dhe zbatimit të gabuar në praktikë nga KSHZ i vendimit të KRR nr. 10/2024.



Të dy faktet e konstatuara mësipër, që burojnë nga shkëlja e dy parimeve thelbësore të së drejtës së regjistrimit të votuesve nga jashtë, kanë sjellë si pasojë cënim dhe pamundësim të ushtrimit të së drejtës për të qenë zgjedhës i regjistruar e më pas votues nga jashtë vendit.

Ndërkohë edhe më shqetësuese është fakti që në këtë numër kaq të lartë refuzimesh, nuk përfshihen kategoritë e tjera të shtetasve shqiptarë, të cilët për hir të rrethanave të ndryshme objektive dhe subjektive, nuk janë pajisur asnjëherë me dokument biometrik të shtetit shqiptar.

Më konkretisht sjellim në vëmendjen tuaj se:

Është fakt i njohur botërisht se emigracioni masiv i dekadës së fundit dhe largimi i shqiptarëve jashtë vendit, kanë ndikuar ndjeshëm në uljen e numrit të popullsisë prezente fizikisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ndonëse i kontestuar dhe jo plotësisht transparent, Censusi i fundit i popullsisë tregoi një prezencë prej gati 2.4 milion banorësh në Shqipëri, përfshirë qindra mijëra fëmijë nën 18 vjeç (pra pa të drejtë vote).

Në Raportin Përfundimtar të OSBE-ODIHR për monitorimin e zgjedhjeve të fundit vendore të 14 Majit 2023, konstatohet se në 2023 ishin të paktën 271,000 zgjedhës me letërnjoftime të skaduara. Por, nga viti 2023 deri më tani, situata është përkeqësuar ndjeshëm.

Ndërkohë, në listat e zgjedhësve me të drejtë vote të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Janar 2025, figurojnë mbi 3.7 milion votues.

Raporti paraprak NAM (Needs Assessment Mission) i OSBE-ODIHR, për zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025, (raport që mban datat 3 dhe 6 Dhjetor 2024), evidenton se rreth 600.000 (gjashtëqind mijë) zgjedhës janë me letërnjoftime të skaduara.

Nga ky numër, referuar të dhënave nga Kompania Identikit rezulton se rreth 170.000 shtetas shqiptarë, pavarësisht se figurojnë në Listat e zgjedhësve shqiptarë, nuk janë pajisur kurrë me letërnjoftim apo pasaportë biometrike shqiptare. Në pjesën dërmuese, shtetasit pa ID apo Pasaportë shqiptare, vlerësojmë (po të analizojmë logjikisht) rezulton se janë me banim jashtë vendit.

Lidhur me arsyet e mungesës së një dokumenti identifikimi të mbi 170 mijë shtetasve shqiptarë mund të citojmë por pa u kufizuar raste si: pajisja me një pasaportë biometrike e një vendi tjetër të Bashkimit Europian apo të një vendi tjetër tejet të sigurtë si SHBA, Kanada, Australi, dhe vende të tjera jashtë Shengenit, por pjesë e marrëveshjeve ekonomike me vendin tonë, pasaportat e të cilave iu kanë ofruar më shumë të drejta në qarkullimin e lirë civil se sa Pasaporta e vendit tonë, për shkak të kërimit të azilit politik, për hir të kërimit të mbrojtjes për arsye gjakmarrje, etj etj. Vlen të theksojmë faktin se të gjithë 170 mijë zgjedhësit shqiptarë që nuk disponojnë një dokument shqiptar biometrik, mund të lëvizin lirisht në Shqipëri, shtete të BE, SHBA, KANADA etj, dhe në të gjitha këto shtete ku ata lëvizin lirisht identifikohen me dokumentet biometrike të huaja.

Pavarësisht arsyeve jo shteruese të tyre, fakti është se të gjithë këta shtetas shqiptarë kanë garancinë Kushtetuese të së drejtës së votës, që i përlligj për ta ushtruar me çdo kusht këtë të drejtë e pa pengesa. Kështu, referuar nenit 45 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë rezulton se shtetasit shqiptarë me mbushjen e moshës 18 vjeç qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, kanë të drejtën të zgjedhin dhe të zgjidhen. Pra, e drejta kushtetuese e votës së gjithë shtetasve shqiptarë (pavarësisht



nëse disponon apo jo dokument identifikimi shqiptar) është e pavarur e pakushtëzuar dhe ndërkohë e garantuar nga Kushtetuta. Kjo e drejtë kushtetuese nuk kushtëzohet nga asnjë kriter tjetër veç shtetësisë shqiptare dhe moshës 18 vjeç e sipër. Qartazi të gjithë 170 mijë zgjedhësit pa dokument shqiptar identifikimi (pasaportë ID) i përmbushin kriteret kushtetuese: 1) të moshës mbi 18 vjeç (pra fitojnë statusit e zgjedhësit dhe përfshihen pasivisht në listën e zgjedhësve shqiptarë) dhe 2) kanë shtetësi shqiptarë.

Në përmbledhje të sa mësipër, theksojmë faktin se pavarësisht nëse shtetasit shqiptarë disponojnë apo jo një dokument identifikimi shqiptar, pavarësisht nëse dokumenti i tyre shqiptar është i skaduar apo jo, të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç, në raport me të drejtën e votimit, referuar nenit 45/1 të Kushtetutës së Shqipërisë janë të BARABARTË.

Në analizë të fakteve të sipërcituara, rezulton se numri i zgjedhësve nga jashtë, të cilët nuk disponojnë një dokument identifikimi biometrik (pra rreth 170.000 shtetas shqiptarë pa Pasaportë/Id), është pothuajse njëloj sa numri shtetasve shqiptarë të regjistruar në PER për të votuar nga jashtë shtetit, (rreth 175.000 shtetas shqiptarë që disponojnë një dokument identifikimi biometrik Pasaportë/Id).

Bazuar në sa mësipër, vlerësojmë se të gjithë Institucionet e Shtetit duhet të sensibilizohen në përmbushje të kësaj drejte kushtetuese. Vlen të evidentojmë faktin se pikërisht nën këtë frymë Qeveria Shqiptare ka miratuar Aktet Normative 1 dhe 2 datë 5.2.2025, me të cilët ka shtyrë deri në datë 31 Maj 2025 vlefshmërinë e pasaportave dhe ID-ve të skaduar për shtetasit shqiptarë jashtë vendit me qëllim ushtrimin e së drejtës së votës.

Theksojmë se ndryshimet e propozuara janë të domosdoshme me qëllim mundësimin efektiv të ushtrimit të së drejtës së tyre kushtetuese për të votuar, në zgjedhjet e përgjithshme të datës 11 Maj 2025, si dhe në kuadër të realizimit dhe respektimit të parimit të gjithpërfshirjes dhe njëherësh të garantimit të së drejtës së votës për të gjithë shtetasit shqiptarë kudo ku ata ndodhen, pa asnjë dallim e pengesë, pavarësisht llojit të dokumentit të tyre të identifikimit që posedojnë, mjafton të jenë të identifikuar dhe të rezutojnë në listat e zgjedhësve të dala nga Regjistri i Shtetasve Shqiptarë.

Nën këtë frymë, me iniciativën tonë dhe edhe votën tuaj le të shënojmë një hap të rëndësishëm e garantues duke hequr nga përmbajtja e aktit, çdo fjalë apo kushëzim i cili përbën pengesë dhe i mohon ushtrimin e së drejtës së votës padrejtësisht qindra mijëra shtetas shqiptarë brenda dhe jashtë vendit dhe rrjedhimisht t'i hapet mundësia e njohjes për efekt të pjesëmarrjes në votim të të gjithë shtetasve shqiptarë¹ që paraqesin një dokument identifikimi biometrik të një shteti tjetër, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet e BE, vendet e zones Schengen, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Australi, Zeland e Re, Japoni apo vendet me të cilat Shqipëria ka marrëveshje ekonomike të Zonës Europiane (EEA), etj.

Referuar gjithë sa sipër u relatua, rezulton e qartë se nevoja për ndryshime në aktin nr.10/2024 të Komisionit Rregullator është padyshim ngritje dhe ruajtje e standartit të respektimit të lirive dhe të

¹ Kategoria e personave të prekur drejtëpërdrejtë nga kjo nismë, sipas të dhënave nga kompania Identitik referohet të jenë rreth 170 mijë shtetas shqiptarë me të drejtë vote por që nuk janë pajisur kurrë me pasaportë ose letërnjoftim biometrik nga Republika e Shqipërisë.



drejtave themelore të shtetasve të një vendi demokratik, dhe i shërben procesit zgjedhor për ta bërë atë me integritet, të lirë, të barabartë, pa pengesa, të padiferencuar, të drejtë dhe çlirues.

Në këtë kontekst, për të mundësuar premisën kushtetuese të mundësimit të së drejtës së votës të 170 mijë shtetasve shqiptarë, me anë të këtij propozimi, dy anëtarët e Komisionit Rregullator H.Vukaj dhe M.Çakaj propozojnë miratimin e ndryshimeve si vijon:

Konkretisht ndryshimet dhe shtesat që vijnë përmes këtij propozimi janë të natyrës normative dhe kanë të bëjnë konkretisht me riformulimin e Kreut III.2 “Regjistrimi në listën e zgjedhësve”, ku në shkronjën “a” të pikës 3, propozojmë që kjo pikë të riformulohet si vijon:

1. Në Kreun III.2. Regjistrimi në listën e zgjedhësve, shkronja “a” e pikës 3, riformulohet si vijon:
..“Skanon përmes PER një dokument identifikimi biometrik, pasaportë për jashtë shtetit ose letërnjoftim, të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, ose dokument identifikimi biometrik, pasaportë për jashtë shtetit ose letërnjoftim, të lëshuar nga vendet e Bashkimit Europian, vendet e Zonës Schengen, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Australi, Zelandë e Re dhe çdo vend tjetër pjesë e Marrëveshjes së Zonës ekonomike EEA. PER lexon dhe ngarkon automatikisht në platformë të dhënat që përmban dokumenti i identifikimit. Nëse për arsye të ndryshme këto të dhëna nuk ngarkohen automatikisht, atëherë zgjedhësi i ngarkon ato në PER në mënyrë manuale. Në çdo rast PER i krijon mundësi zgjedhësit që të ngarkojë të skanuar dokumentin përkatës të identifikimit. ...”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Sa më lart në këtë relacion, si anëtarë të Komisionit Rregullator, brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, propozojmë për shqyrtim dhe miratim nga Komisioni Rregullator, projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 10, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, me titull **“NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE, Të NDRYSHUAR”**”.

ANËTARËT E KOMISIONIT RREGULLATOR

HELGA VUKAJ

MUHAREM ÇAKAJ

